

REGJISTRI I KERKESAVE DHE PERGJIGJEVE PRILL- QERSHOR 2022

Nr. rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
596	30.03.2022	Kerkese : Per material teknik dhe grafike per objektin me kodin K-141	15.04.2022	Ne vijim të kërkesës Suaj, date 30.03.2022, administruar pranë Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore me Nr. 596 Prot., datë 30.03.2022, në mbështetje të Ligjit Nr.9154, datë 6.11.2003 "Për Arkivat" dhe ligjit Nr. 119/ 2014 "Për të drejtën e informimit", ju sqarojmë se: Objekti me kod K-141 me ish pronar Vangjel Capi dhe Lili Qemeri, administrohet në dosjen teknike të arkivit teknik me emërtimin "Banesa e Meleq Mehmetit" (Vangjel Capi), me kod (K-141), në lagjen "Kala", Berat. Kopje e materialit arkivor për këtë objekt ju është dërguar ne format elektronik. Sa më sipër, nuk disponojmë asnjë dokumentacion tjetër lidhur me objektin me kod K-141.	E plotë	Jo
598/1	30.03.2022	Kerkese per material ne arkive	26.04.2022	Bashkelidhur gjen shkresen kthim pergjigje per F. I. dhe materialet ne link si dhe teksti ne word i shkreses Në vijim të kërkesës Suaj datë 17.03.2022, administruar pranë Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore me Nr.598 Prot., datë 30.03.2022, mbështetur në Ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 "Për Arkivat" dhe ligjin Nr. 119/ 2014 "Për të drejtën e informimit", Ju vendosim në dispozicion bashkëlidhur në link https://we.tl/t-frdkzwZXzV kopje të materialit të vjetër arkivor si: planimetri e kullave dhe përshkrim historik për objektin "Kalaja e Kaninës". Sa më sipër, lutemi për çdo dokument të përdorur të citohet burimi nga është marrë (Arkivi Teknik i IKTK).	E plotë	Jo
462/1	30.03.2022	Kërkesë për informacion	04.04.2022	Bashkelidhur do te gjeni shkresen me Nr. 462/1 Prot., date:30.03.2022, me pergjigjen nga Instituti Kombetar i Trashegimise Kulturore (IKTK) , ne lidhje me kerkesen tuaj per informacion per praktiken e aplikimit "Kompesim i nje siperfaqe toke 4.5ha brenda kufirit te Parkut Arkeologjik Bylis" me aplikues .. Gjithashtu, ju informojme se shkresa ndodhet ne Sekretarine Teknike te IKTK, nga ku mund ta terhiqni fizikisht.	E plotë	Jo
Email	01.04.2022	Kërkesë për informacion	13.04.2022	Ne pergjigje te kerkeses per informacion sipas emailit te dates 01.04.2022, gjeni sa me poshte pergjigjet per secilen nga pyetjet bashkelidhur kerkeses.	E plotë	Jo

				Keni dijeni për Urën e Zogut që është drejt shkatërrimit dhe nëse po përse nuk është marrë asnjë masë deri tani? A ka një plan për të restauruar këtë urë? Lidhur me problematikën e Urës së Matit, Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore është pjesë e Grupit të punës të caktuar për bashkëpunimin ndërinstytucional në nivel ekspertësh për të përcaktuar shkaqet që kanë sjellë dëmtimin e objektit pasuri kulturore, si dhe indentifikimin e masave emergjente dhe afatgjata që duhen ndërmarrë për eliminimin e shkaqeve e pasojave. Për sa më sipër, procesi i hartimit të projektit për ndërhyrje përkatëse, do të jetë produkt i përbashkët i institucioneve që janë pjesë e këtij bashkëpunimi. Ura e Kamarës rrezikon të shembet, a keni dijeni për këtë dhe kur pritet të merren masa për restaurimin e saj? Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore ka hartuar projektin për ndërhyrje restauruese / konservuese në këtë objekt pasuri kulturore në vitin 2019. Aktualisht, IKTK ha hartuar projektin e rishikuar i cili është në fazën e shqyrtimit nga Këshillet përkatëse. Ura e Kordhocës është restauruar pjesërisht në vitin 2018 vetëm në dy nga këmbët e saj, por kjo urë vazhdon të jetë e dëmtuar. A ka ndonjë plan për restaurimin e plotë të saj? Instituti Kombëtar ka hartuar projektin e ndërhyrjeve tërësore restauruese konservuese në këtë objekt pasuri kulturore, në vijim të ndërhyrje të realizuara në vitin 2018. Sa ura dhe objekte të tjera të trashëgimisë kulturore janë të dëmtuara dhe të rrezikuara për t'u shembur në Shqipëri? Inspektimi i gjendjes e konservimit të pasurive kulturore kryhet në mënyrë periodike nga Drejtoritë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore, brenda territorit që administrohet prej tyre dhe në zbatim të përcaktimeve të ligjit nr.27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.		
613/1	05.04.2022	Kërkesë për informacion	14.04.2022	Në vijim të kërkesës Suaj, datë 04.04.2022, administruar në Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore me Nr. 613 Prot., datë 05.04.2022, ku kërkohet informacion mbi banesën e Gani Kuqit e ndodhur në qytetin e Krujës, Ju bëjmë me dije se: Nga verifikimi i kryer në listën zyrtare të pasurive kulturore dhe vendimeve të shpalljeve apo heqjeve të këtyre pasurive, rezulton se banesa e Gani Kuqit në Krujë nuk gëzon status mbrojtjeje në cilësinë e monumentit të kulturës.	E plotë	Jo

				Ky objekt nuk rezulton të ketë pasur status mbrojtje rrjedhimisht nuk ka vendim për heqjen e këtij të fundit. Gjithashtu, në arkivin e IKTK-së nuk ka kartelë pasurie kulturore. Sa më sipër, në mungesë të statusit pasuri kulturore, verifikimi i dëmeve të shkaktuara nga tërmeti apo marrja e masave nuk është kompetencë e Intitutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore. Në përfundim, pavarësisht statusit, objekti në fjalë është në vëmendjen e IKTK-së, për verifikim të interesit kulturor të mundshëm në vijimësi.		
Email	05.04.2022	Kërkesë për informacion	13.04.2022	Bashkëngjitur do të gjeni një kopje në pdf të Revistës "Monumentet" 1989/2 (38). Jeni i lutur që për çdo pjesë teksti apo foto nga ky publikim, të citohet burimi, autori dhe të respektohen referencat përkatëse. Ju falënderojmë për bashkëpunimin! Punë të Mbarë!	E plotë	Jo
615	05.04.2022	Kërkesë për informacion	19.04.2022	Prona ndodhet brenda kufirit të qendres historike të qytetit të Pogradecit; Lidhur me statusin apo historikun e pronës, Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore nuk administron të dhëna lidhur me ceshtjet e pronësive, historikun apo transaksione të munshme me titujt e pronësive.	E plotë	Jo
Email	08.04.2022	Kërkesë për materiale	26.04.2022	Në vijim të kërkesës suaj të datës 08.04.2022 me email në adresën zyrtare të IKTK-së, pas miratimit të eprorit, gjeni bashkëlidhur projektin "Restaurimi i banesës së Temo Çelajt, Klos, Mallakastër" monument kulture i kategorisë së parë, të hartuar nga IKTK dhe miratuar me Vendimin të KKTKM-së Nr. 634, datë 12.11.2021.	E plotë	Jo
670	12.04.2022	Kërkese për material arkivor Kafja e Madhe Shkodër	22.04.2022	Në vijim të kërkesës Suaj date 11.04.2022, administruar pranë Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore me Nr.670 Prot., datë 12.04.2022, mbështetur në Ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 "Për Arkivat" dhe ligjit Nr. 119/ 2014 "Për të drejtën e informimit", Ju vendosim në dispozicion bashkëlidhur në link https://we.tl/t-isUM4810pg kopje elektronike të projektit: Restaurim i godinës "Kafja e Madhe", Shkodër, të miratuar me Vendim KKR Nr. 168, date 08.07.2016 dhe azhurnimet e projektit miratuar me Vendim KKR Nr. 237, date 04.11.2016.	E plotë	Jo
671	12.04.2022	Kërkesë për dokumentacion grafik	22.04.2022	Ne vijim të kërkesës suaj me date 12.04.2022, administruar pranë IKTK me Nr. 671, date 12.04.2022, mbështetur në Ligjin	E plotë	Jo

				Nr.9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat” dhe ligjit Nr. 119/ 2014 “Për të drejtën e informimit”, Ju vendosim në dispozicion bashkëlidhur ne link dokumentacionin grafik dhe fotografik per objektet ne qarkun Shkodër si me poshte: ☐ Banesa e Ndue Mark Koles; ☐ Qyteza e Dakajve (vetem dokumentacion fotografik); ☐ Banesa e Shkurte Alia; ☐ Banesa e Marash Koles; ☐ Banesa e Hysen Hotit. Për objektin “Vendbanimi prehistorik i sistemit tarracor”, nuk disponojmë dokumentacion grafik apo fotografik.		
673	12.04.2022	Kërkesë e Avokatit te popullit	27.04.2022	Në përgjigje të kërkesës Suaj, administruar pranë Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore (IKTK), me nr. 673 prot., datë 12.04.2022, lidhur me ankesën e paraqitur nga ana e z. Neritan Ceka mbi planin e menaxhimit të Parkut Arkeologjik Bylis (PAB), Ju bëjmë me dije se: Plani i menaxhimit të PAB, është një projekt që financohet nga Bashkimi Evropian (BE) nëpërmjet Delegacionit Evropian në Shqipëri dhe Programit “IPA II 2018 Action Programme for Albania - EU Economic Development – Tourism – led local economic development with focus on cultural heritage” (IPA II 2018 Programi i veprimit për Shqipërinë – BE Zhvillimi Ekonomik – Turizmi – udhëheqës i zhvillimit ekonomik lokal me fokus trashëgiminë kulturore). Sipas projekt fishës së Programit të vitit 2018, qëllimi i këtij programi është mbrojtja, ruajtja dhe restaurimi i trashëgimisë kulturore, përmirësimi i turizmit të qëndrueshëm në këto zona, duke rritur zhvillimin ekonomik dhe mjedisor lokal. Shtimi i atraksioneve turistike do të mundësojë rritjen e të ardhurave duke e zgjatur sezonin turistik dhe duke ofruar vende pune për popullsinë vendase. Vlera totale e programit është 6 milion Euro dhe parashikon: - hartim plane menaxhimi, studime fizibiliteti - hartim projektsh dhe zbatim të punimeve, -përmirësim të infrastrukturës përreth aseteve të trashëgimisë kulturore duke përfshirë aksesueshmërinë, menaxhimin e mbetjeve dhe kërkesat sanitare, - asistencë teknike, promovim dhe rritje kapacitetesh,	E plotë	Jo

			duke përfshirë gjithashtu projekte potenciale për investim sipas prioriteteve dhe rëndësisë në rradhë si vijon: - në rajonin e Fierit - Parku Arkeologjik i Bylisit, - punime restauruese shtesë në monumentet që ndodhen në 4 zonat pilot nga Programi IPA 2017 – si konsolidimi dhe restaurimi i afreskëve në kishat e (Voskopojës, Vithkuqit, Beratit dhe Apollonisë), - zona të përzgjedhura nga Programi i Qeverisë së Shqipërisë “100 Fshatrat”, - Asete kulturore përgjatë gjurmës së “Rrugëve të besimit”, si shembuj të harmonisë fetare të tre besimeve në Shqipëri. Instituti i Monumenteve të Kulturës në vitin 2018, ka hartuar draft të termave të referencës (ToR’s), të cilat u miratuan me Vendim KKR nr. 274 datë 31.05.2018. Në vitin 2019, Delegacioni European inicioi një proces për rishikimin e ToR’s me qëllim përmirësimin e tyre, duke kërkuar një konsultim më të gjerë dhe përfshirjen e të gjithë institucioneve të lidhura me Parkun Arkeologjik Bylis. Në këtë proces u përfshinë dhe dhanë kontribut institucionet si Ministria e Kulturës, IMK dhe ASHA (sot IKTK), Instituti i Arkeologjisë, ZAKPA Bylis, si dhe zyrat e Delegacionit European. Një version i integruar i ToR’s të rishikuar dhe dakortësuar mes palëve, i’u përcoll Delegacionit European nga ana e IKTK-së. Në dhjetor 2020 Delegacioni Evropian lidhi një marrëveshje kontributi me Agjencinë Italiane për Bashkëpunim dhe për Zhvillim (AIBZH) - AICS Tirana Office duke e përzgjedhur atë në një garë ndërkombëtare si “njësi menaxhuese” të Programit “IPA II 2018 Action Programme for Albania - EU Economic Development – Tourism – led local economic development with focus on cultural heritage” Nga ana e AICS është dorëzuar pranë Ministrisë së Kulturës dhe IKTK-së, Drafti – i Planit të Menaxhimit të Integruar për Bylisin dhe Klosin 2022-2026, me shkresë nr. 7 prot., dt. 16.12.2021, protokolluar në MK me nr. 6491 dt. 16.12.2021. Ky plan është hartuar nga AIBZH me ndihmesën teknike edhe të Universitetit të Bolonjës dhe Rajonit të Emilia-Romagna. Drafti i PMI u mor në shqyrtim nga MK-ja dhe IKTK-ja, duke e vlerësuar në raport me VKM Nr.169, datë 20.02.2020. MK-ja dhe IKTK-ja konkluduan me komente dhe sugjerime të përbashkëta duke i’u përcjellë ato AICS-së me shkresë të MK nr.99 prot., dt.		
--	--	--	--	--	--

				11.01.2022. Aktualisht nga ana e AICS, ende nuk ka mbërritur zyrtarisht plotësimi i vërejtjeve dhe komenteve të kërkuara nga ana e MK-së dhe IKTK-së. Sa i përket përmbajtjes së pjesës historike të draftit të PMI-së, sikurse është sqaruar më sipër në lidhje me komentet dhe sugjerimet e kërkuara, ato do të shqyrtohen në momentin kur ky dokument të paraqitet i përgatitur në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për trashëgiminë kulturore dhe VKM Nr.169, datë 20.02.2020. Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, është institucion përfitues i këtij Programi dhe nuk është autoriteti përgjegjës për lidhjen e kontratave këtij projekti.		
677/1	13.04.2022	Kërkesë për informacion A. M.	28.04.2022	Ne pergjigje te shkreses suaj administruar prane IKTK, me nr. 677 prot., datë 13.04.2022, Ju bëjmë me dije se: IKTK-ja bazuar në ligjin nr. 27/2018 "Për Trashëgimime Kulturore dhe Muzetë", është institucion i specializuar në varësi të Ministrisë së Kulturës i cili ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore. Sa i takon ankesës Suaj, miratimi i lejes së ndërtimit dhe kondicioneve urbane të saj, nuk është në fushën e kompetencës së IKTK-së, por e organeve të qeverisë vendore. Leja sektoriale e miratuar n Këshillin Kombëtar te Trashëgimisë Kulturore Materiale (KKTKM), është njëri nga dokumentat e nevojshme, mbi bazën e të cilave organet e qeverisjes vendore shqyrtojnë dhe marrin vendimet përkatëse sipas ligjit për planifikimin e territorit. Bashkelidhur gjeni, Vendim nr. 77 dt. 08.04.2022 të KKTKM, "Rindërtimi i banesës 2 dhe 3 kate + podrum, brenda kufirit të Qendrës Historike Korçë" me zhvillues I. F.		
681	13.04.2022	Kërkesë për informacion	26.04.2022	Ne vijim te kerkeses Suaj date 13.04.2022, administruar prane IKTK me Nr. 681, date 13.04.2022, mbështetur në Ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 "Për Arkivat" dhe ligjin Nr. 119/ 2014 "Për të drejtën e informimit", ju vendosim në dispozicion bashkëlidhur në link https://we.tl/t-dMDmaHhDAS kopje të materialit të vjetër arkivor grafik dhe fotografik për objektin "Manastiri i Shen Merise", ne fshatin Goranxi, Dropull.	E plotë	Jo
Email	18.04.2022	Kërkesë për material në arkivë,	09.05.2022	Ne vijim bashkelidhur gjeni relacionin teknik te para viteve 90-te qe disponojme ne arkiv, per Forumin Bizantin (Rotonda), ne qytetin e Duresit.	E plotë	Jo
707	19.04.2022	Kërkesë për material arkivore	28.04.2022	Ne vijim te kerkeses Suaj, administruar prane IKTK me Nr. 707, date 19.04.2022, mbështetur në Ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003	E plotë	Jo

				“Për Arkivat” dhe ligjin Nr. 119/ 2014 “Për të drejtën e informimit”, ju vendosim në dispozicion bashkëlidhur në link https://we.tl/t-hx7Lbfu7zE kopje digjitale të dokumentacionit grafik arkivor per objektet ne qytetin e Durresit: 1. Amfiteatri; 2. Kisha e Amfiteatrit dhe Mozaiku; 3. Kulla veneciane; 4. Forumi Bizantin (Rotonda); 5. Termat 6. Xhamia Fatih; 7. Pusi i Top Hanes; 8. Kalaja e Durresit; 9. Bukuroshja e Durresit(Mozaiku) (vetem dokumentacion fotografik). Per objektin “Bazilika e Shen Mehilit”, nuk disponojme dokumentacion arkivor.		
708	19.04.2022	Kërkesë për material arkivore	26.04.2022	Ne vijim te kerkeses suaj date 19.04.2022, administruar prane IKTK me Nr. 708, date 19.04.2022, mbështetur në Ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat” dhe ligjin Nr. 119/ 2014 “Për të drejtën e informimit”, ju vendosim në dispozicion bashkëlidhur në link kopje të materialit të vjetër arkivor si: Planimetri dhe foto te vjetra për objektin “Hamami prane shkolles”, Durres.	E plotë	Jo
709	19.04.2022	Kërkesë për informacion	06.05.2022	Në përgjigje të shkresës suaj, datë 19.04.2022, administruar pranë Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore me Nr. 709 Prot, datë 24.03.2022, lidhur me kërkesën për informacion mbi sitin arkeologjik të konstatuar në fshatin Sherishtë të qytetit Vlorë ju informojmë se: Në mbledhjen e datës 17.10.2018 të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë, (KKA) me vendim Nr. 217, është miratuar raporti i vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor në kuadër të projektit "Menaxhimi i integruar i mbetjeve të ngurta të Rajonit të Vlorës", Sherishtë, Vlorë. Bazuar në këtë vendim, është lidhur akt-marrëveshja tre palëshe (IKTK – Bashkia Vlorë dhe subjekti i licencuar Znj. Lida Miraj Zeqo), me Nr.1625/1 Prot., datë 11.08.2020 me objekt, ndjekjen në mënyrë periodike ditore të punimeve nga subjekti i licencuar në arkeologji dhe IKTK si mbikëqyrës i tij. Në vijim, në postën elektronike të IKTK, në datën 01.12.2020 nga Znj. Lida Miraj, janë përcjellë me e-mail 4 raporte monitorimi arkeologjik të realizuara për ndjekjen periodike të	E plotë	Jo

			punimeve në kantier. Në të katër raportet e monitorimit të përgatitura nga Znj. Miraj, “...relatohet se nuk ka anjë gjetje të materialit arkeologjik...”. Në datën 22.12.2020, specialistët e IKTk-së, realizuan mbikëqyrjen arkeologjike në terren, në prani të përfaqësuesve të bashkisë Vlorë, supervizorit të punimeve të kompanisë “Dahlem”, zbatuesit “Bulfaro”, si dhe individ të licencuar në arkeologji znj. Lida Miraj. Nga mbikëqyrja në terren, u konstatua se gjatë punimeve zbatuese të landfillit në anën jug-lindore të zonës së landfillit (fundi i qelizës së parë), u konstatua materialit i konsiderueshëm arkeologjik. Në zbatim të ligjit Nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë” u mbajt një procesverbal Nr. 209/1 Prot, datë. 30. 12. 2020. Më anë të këtij procesverbali u pasqyrua situata e konstatuar në terren dhe në zonën ku u dolën gjetjet e materialit arkeologjike punimet zbatuese u pezulluan nga specialistët e IKTk. Relacioni mbi mbikëqyrjen në terren dhe konstatimit të materialit arkeologjik, në kuadër të projektit “Menaxhimi i integruar i mbetjeve të ngurta të rajonit të Vlorës,” Sherishtë, Vlorë, i përgatitur nga specialistët e IKTk, Nr. 35 prot, datë.19. 01. 2021, u paraqit për shqyrtim dhe vendimmarrje pranë KKTKM në përputhje me dispozitat ligjore të përcaktuara në ligjin Nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”. Në vijim, bazuar në realcionin për gjetjet arkeologjike, Këshillit Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale me vendim Nr. 44 prot, Nr, 18, datë. 21.01.2021, përcaktoi: • Miratimit e relacionit të mbikëqyrjes për gjetjet arkeologjike në terren në kuadër të projektit “Menaxhimi i integruar i mbetjeve të ngurta të rajonit të Vlorës”, Sherishtë, Vlorë. • Të realizohen sondazhe nga persona të licencuar në arkeologji brenda zonës ku janë konstatuar gjetjet arkeologjike. • Investitori duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje 3 palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, për kryerjen e sondazheve arkeologjike dhe Institutit të Trashëgimisë Kulturore, i cili do të mbikëqyrë këtë subjekt. Në përputhje me detyrimin e përcaktuar nga vendimi i KKTKM, Sondazhet arkeologjike u gërmuan nga idivid i licencuar në arkeologji Znj. Iris Pojani, e cila u kontraktua nga investitori për		
--	--	--	---	--	--

				realizimin e këtij procesi, i cili u mbikëqyr nga specialistët e IKTK. Më pas, rezultati i sondazheve arkeologjike u paraqit për shqyrtim dhe vendimmarrje në Këshillin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, e cila me Vendim Nr. 225, Nr. 635 prot, datë. 23. 04. 2021, përcaktoi; • Miratimin e raportit të Sondazheve arkeologjike në kuadër të projektit “Impianti i trajtimit të mbetjeve të ngurta të rajonit të Vlorës”, Bashkia Vlorë, përgatitur nga individ i licencuar Znj. Iris Pojani. Relacionin e verifikimit nga DSHA. • Miratimin e konceptit të gërmimit arkeologjik të shpëtimit për qelizën 1, të projektit “Impianti i trajtimit të mbetjeve të ngurta të rajonit të Vlorës”, përgatitur nga individ i licencuar Znj. Iris Pojani. • Investitori duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshjen 3 palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji Znj. Iris Pojani, i cili do të ndjekë në menyre periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit të projektit “Impianti i trajtimit të mbetjeve të ngurta të rajonit të Vlorës”, si dhe Institutit të Trashëgimisë Kulturore, i cili do të mbikqyrë këtë subjekt. Sqarojmë se, aktualisht ende nuk është realizuar gërmimi arkeologjik i përcaktuar me vendimin e sipërcituar të KKTKM, pasi investitori nuk është paraqitur pranë IKTK për lidhjen e akt-marrëveshjes përkatëse. Ndërkohë, në zonën ku janë konstatuar gjetjet arkeologjike dhe për të cilat është marrë vendimi për realizimin e gërmimit arkeologjik, janë pezulluar. Sa i përket konsultimeve me banorët e zonës në lidhje me ndërtimin e “Impiantit të trajtimit të mbetjeve të ngurta, Sherishtë Vlorë”, sqarojmë se kjo nuk është në kompetencë të IKTK. Bashkëlidhur, gjeni kopjet e vendimeve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë dhe Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale.		
Email	26.04.2022	Kërkesë për material në arkivë,	26.04.2022	Ne vijim te kerkeses Suaj date 13.04.2022, administruar prane IKTK me Nr. 681, date 13.04.2022, mbështetur në Ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat” dhe ligjin Nr. 119/ 2014 “Për të drejtën e informimit”, ju vendosim në dispozicion bashkëlidhur në link kopje të materialit arkivor për objektet si me poshte:	E plotë	Jo

				1. "Kisha e Manastirit te Shen Merise se Drianos", Zervat, Gjirokaster. Linku https://we.tl/t-DiQnsZTBYB Dokumentacioni arkivor do ju dergohet personave me email si me poshte:		
Email	26.04.2022	Kerkese per info, projekti Heaven, Vrine, Konispol	05.05.2022	Në vijim të kërkesës për informacion për projektin "Jonian Heaven", e ndodhur në zonën e Vrinës, Bashkia Konispol, sqarojmë se: Pranë Institutit Kombëtar të Trashëgimise Kulturore nuk është administruar Aplikim/kërkesë për mendim nga AIDA për një projekt të tillë dhe gjithashtu, KKA/KKTKM nuk kam marrë në shqyrtim një projekt me këtë emërtim.	E plotë	Jo
Email	27.04.2022	Kërkesë për material në arkivë	13.05.2022	Në vijim të kërkesës Suaj, datë 27.04.2022, në mbështetje të Ligjit Nr.9154, datë 6.11.2003 "Për Arkivat" ju bëjmë me dije se Arkivi Teknik nuk disponon materiale që mund t'i përgjigjen kërkesës tuaj. Per projektin tuaj, ju mund te paraqiteni prane bibliotekes se IKTK per tu konsultuar me literaturen. Duke Ju falenderuar,	E plotë	Jo
Email	01.05.2022	Kërkesë për material në arkivë	16.05.2022	Në vijim të kërkesës Suaj datë 01.05.2022, në mbështetje të Ligjit Nr.9154, datë 6.11.2003 "Për Arkivat", ju vendosim ne dispozicion bashkelidhur ne link kopje te dokumentacionit arkivor grafik si planimetri dhe pamje te vitit 1969, per objektin pasuri kulturore "Banesa e Hajdar Sejdinit", sot Muzeu Etnografik, ne qytetin e Elbasanit.	E plotë	Jo
750	27.04.2022	Kerkese per informacion M. B.	09.05.2022	Në vijim te kërkesës Suaj date 27.04.2022, administruar pranë Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore me r. 750 Prot., datë 27.04.2022, mbeshtetur në Ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 "Per Arkivat" dhe ligjit Nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", Ju vendosim n dispozicion bashkelidhur ne link https://we.tl/t-1GTegG13DI kopje te dokumentacionit arkivor për objektin "Kalaja e Borshit", si më poshtë: • Relacion përshkrimor i kalasë; • Planimetri e xhamisë; • Foto te vjetra. Sa më sipër, lutemi për do dokument të perdorur te citohet burimi nga është marrë (Arkivi Teknik i IKTK).	E plotë	Jo
791	04.05.2022	Kërkesë për material në arkivë	07.05.2022	Në vijim të kërkesës Suaj, Lutemi nga ana juaj të paraqiteni pranë IKTK-së, në kohën që ju mendoni të përshtatshme (çdo	E plotë	Jo

				ditë 08:00-16:30 dhe të premte 08:00 deri në orën 14:00), për të aksesuar dokumentacionin pranë bibliotekës/arkivit.		
Email	09.05.2022	Kërkesë për material në arkivë,	17.05.2022	Në vijim të kërkesës Suaj datë 06.05.2022, mbështetur në Ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat” dhe ligjin Nr. 119/ 2014 “Për të drejtën e informimit”, ju vendosim në dispozicion bashkëlidhur në link https://we.tl/t-YW6IX3Y9te kopje digjitale të dokumentacionit arkivor si rilevime të viteve ’70-të për murin dhe kullat e kalasë së Durrësit. Sa më sipër, lutemi për çdo dokument të përdorur të citohet burimi nga është marrë (Arkivi Teknik i IKTK).	E plotë	Jo
Email	11.05.2022	Kërkesë për info	12.05.2022	Ne lidhje me kërkesen tuaj për paisjen me dokumentin e vlersimit të performancës gjatë praktikës së realizuar në IKTK, duhet të paraqiteni pranë zyrave tona, kur ju të keni mundësi gjatë orarit zyrtar të punës.	E plotë	Jo
Email	12.05.2022	Kërkesë për material fotografik	17.05.2022	Ne vijim të kërkesës Suaj datë 12.05.2022, mbështetur në Ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat” dhe ligjin Nr. 119/ 2014 “Për të drejtën e informimit”, ju vendosim në dispozicion bashkëlidhur në link https://we.tl/t-RK4lrLJrRM kopje digjitale të dokumentacionit arkivor fotografik, pershkrimor dhe planimetri për objektin “Bazilika paleokristiane”, në fshatin Arapaj, Durrës.	E plotë	Jo
Email	12.05.2022	Kërkesë për informacion	17.06.2022	Sa ka qenë gjatësia fillestar e murit dhe sa është prishur nga kompania koncesionare e Portit MBM? Muret e Portës së Porto Romanos, përbëhen nga 5 fragmente muresh me gjatësi: 1. 15m, 2. 11m, 3. 17m, 4. 60m, 5. 2.5m Prej këtyre, gjatë inspektimit të datës 17.05.2022 është konstatuar se dëmtimi ka ndodhur në fragmentet 1. 15m dhe 2. 11m. - Çfarë masash konkrete keni marrë ju ndaj kësaj veprë penale? DRTK Tiranë, pas konstatimit nga specialistet e saj të veprimeve të paligjshme, i ka kërkuar Inspektoriatit për Mbrojtjen e Territorit dhe Drejtorisë së Përgjigjshme të Policisë së shtetit të merren masat e duhura dhe të pezullohen punimet. Nga ana e institucioneve përkatëse janë marrë masat për pezullim të punimeve si dhe është nisur një procedim penal në lidhje me shkeljen e pretenduar. Procedimi penal nuk ka përfunduar ende. Hetimet janë në vijim. - Nga të dhënat tuaja kur ka ndodhur rrëzimi pjesërisht i monumentit dhe kur e keni konstatuar ju? Ne inspektimin e fundit të kryer nga IKTK dhe DRTK Tirane është kontaktuar dëmtimi në fragmentet e sipërcituara.	E plotë	Jo

839	12.05.2022	Kërkesë për informacion për çështjet që lidhen me Amfiteatrën e Durrësit		- Çfarë parashikon projekti për Amfiteatrën, realizuar në Bashkëpunim me Fondin Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim: Në KKTKM janë shqyrtuar dhe miratuar 2 aplikime që lidhen me projektin për Amfiteatrën në vitin 2021: 1. “Restaurimi dhe rikualifikimi urban i zonës perspektive TID të gjendur në Parkun Arkeologjik të Durrësit”, miratuar me Vendim të KKTKM Nr.480, dt.28.07.2021, parashikon: -Zona e parashikuar TID e Durrësit ndodhet brenda kufirit të Zonës Arkeologjike “A” sipas pozicionit në Genplanin e projektit. Ndërhyrjet e parashikuara në projekt kanë si qëllim mbrojtjen e aseteve të pasurive kulturore të Durrës, rritjen e turizmit dhe zhvillimin ekonomik të zonës përmes restaurimit, konservimit dhe rehabilitimit të hapësirave. Projekti parashikon si fazë e parë, identifikimin e gjendjes ekzistuese të gjithë komponentëve përbërës të zonës së interesit (objekteve dhe hapësirave urbane) duke përcaktuar patologjitë përkatëse për secilën; koncepti i ndërhyrjeve bazuar në analizat e konkluzionet e realizuara të cilat kanë si qëllim ndërhyrje rralluese për nxjerrjen në pah të vlerave historik—arkeologjike të zonës; hartimi i konceptit të Planit të Prishjeve bazuar në përcaktimet e Planit Vendor të miratuar (PDyV). Pas miratimit të konceptit të ndërhyrjes dhe prishjeve të parashikuara, ndërhyrjet parashikohen si më poshtë: - Restaurim/rikualifikim dhe harmonizim e fasadave të ndërtesave të zonës së projektit pas realizimit të prishjeve dhe hapjes së hapësirave. - Restaurimin dhe rivitalizimin e mureve të kalasë pas prishjeve të ndërtesave që mbështeten në këto mure. - Harmonizimin dhe përshtatjen e shtresave rrugore me planin e re të zonës pas ndërhyrjeve restauruese. - Përmirsimi i infrastrukturës urbane ku përfshihen ndriçimi rrugor dhe pedonal, ndriçimi i objekteve arkeologjike e historike, sistemimi dhe syrvërimi me kamera ÇTV - Rikonstruksimi i infrastrukturës së kanalizimit të ujërave të zeza dhe drenazhimi i ujërave të shiut. 2. Projekti “Shërbim konsulence për heqjen dhe prishjen e strukturave / ndërtesave në zonën arkeologjike të Durrësit, siç	E plotë	Jo
-----	------------	--	--	---	---------	----

				përshkruhet në raportin e PDyV5” miratuar me Vendim të KKTKM, Nr.691, dt.20.12.2021, parashikon: Projektin e Prishjes për ndërtimet e përcaktuara në PDYV 5 për zonën e Amfiteatrit. Meqenëse zona është e një rëndësie të madhe arkeologjike, Projekti duhet të ketë për secilën ndërtesë një metodologji të punimeve të prishjes të detajuar që ruan rrënojat arkeologjike. Koncepti i prishjeve sipas parashikime në projektin e paraqitur ndahet në dy faza: Faza I: 21 objekte dhe Faza II: 41 objekte. - Kur është parashikuar të nisë projekti? Pranë Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore nuk administrihet një informacion i tillë. Cilat janë projektet kërkimore- shkencore të zhvilluara për studimin e monumentit në vitet 2015-2022? Për çdo informacion lidhur me projektet e miratuara sipas legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore, adresohuni në linkun http://iktk.gov.al/site/#		
Email	17.05.2022	Kërkesë për material në arkivë		Ne vijim te kerkeses suaj mbi objektin “Kisha katolike Shen Luigji Gonzaga”, Vlore, ju bejme me dije se nuk disponojme dokumentacion arkivor per objektin “Kisha Katolike”, ne rrugen “Kristo Negovani”, ne qytetin e Vlores. Objekti eshte shpallur pasuri kulturore ne vitin 2006.	E plotë	Jo
Email	17.05.2022	Kerkese per dokumente mbi banesen ne Gjirokaster, Varosh		Në vijim ju dërgojmë dokumentacionin e kërkuar nga ana juaj, me nr. pasurie 4/502 të zonës kadastrale 8542, Gjirokastër në lagjen Varosh, Monument Kulture I kategorisë së II-të brenda kufirit të Qendrës Historike: 1.Projektin teknik për “Ndërhyrje konservuese restauruese në tavanin dekorativ në banesën Vaso Bakuli”, hartuar nga IKTK; 2. Vendimin e miratuar nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore për “Ndërhyrje konservuese restauruese në tavanin dekorativ në banesën Vaso Bakuli”, nr.72 datë 08.04.2022.	E plotë	Jo
Email	17.05.2022	Kerkese per kopje te projektit restaurimin e Baneses 207, ne fshatin Vuno,	01.06.2022	Në përgjigje të kërkesës suaj të datës 17.05.2022, ju informojmë se pranë arkivit teknik të IKTK-së gjenden të depozituar kopje të projektit të skedës -Banesa Nr. 207, në Vuno, në kuadër të projektit “Kualifikimi urban i objekteve në Qendrat Historike të fshatit Dhërmi dhe Vuno”, hartuar nga shoqëria “Son Engineering & Construction” sh.p.k., si dhe vendimi i miratimit Nr. 349, datë 16.10.2019. Në link gjeni informacionin sipërpërmendur: https://we.tl/t-vZiLcSapAX		

893/1	19.05.2022	Kerkese per vënien në dispozicion të dokumentacionit të projektit		Në vijim të kërkesës Suaj administruar pranë IKTK-së me nr. 893 prot., datë 19.05.2022, për vënien në dispozicion të dokumentacionit të projektit “Rindërtim i banesës 2 dhe 3 kate + podrum”, i miratuar me Vendim të KKTKM-së Nr.77 datë 08.04.2022, Ju bëjmë me dije se: Në bazë të Ligjit Nr.35/2016 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të" si dhe nenit 17, pika 1 gërma c) të Ligjit Nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", projekti me objekt "Rindërtim i banesës 2 dhe 3 kate + podrum", brenda kufirit Qendër Historike, është objekt i mbrojtjes së të drejtës së autorit dhe si i tillë, i nënshtrohet formaliteteve të ligjit të sipërcituar dhe nuk mund të përcillet.	E plotë	Jo
Email	20.05.2022	Kërkesë për material në arkivë	27.05.2022	Ne vijim te kerkeses se Z. L. M., mbështetur në Ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat” dhe ligjin Nr. 119/ 2014 “Për të drejtën e informimit”, bashkelidhur ju vendosim ne dispozicion kopje digjitale te dokumentacionit arkivor grafik, fotografik dhe pershkrimor per objektin “Banesa e Dud Mishaxhiu”, ne qytetin e Beratit. Sa më sipër, lutemi për çdo dokument të përdorur të citohet burimi nga është marrë (Arkivi Teknik i IKTK). https://we.tl/t-wqqN1a4KqN	E plotë	Jo
Email	20.05.2022	Kërkesë për material në arkivë	31.05.2022	Ne vijim te kerkeses se Z. Th. M., mbështetur në Ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat” dhe ligjin Nr. 119/ 2014 “Për të drejtën e informimit”, bashkelidhur ju dergojme ne link dokumentacionin arkivor per objektin e dyte ne pronesi te Z. Thoma Miho (M-097), ne lagjen “Mangalem”, ne qytetin e Beratit. https://we.tl/t-Hp05JXucKe	E plotë	Jo
Email	21.05.2022	Kerkese per materiale	02.06.2022	Në përgjigje të kërkesës Suaj të datës 21.05.2022, ju bëjmë me dije se projekti me objekt “Restaurimi i Kishës së Shpërfytyrimit”, në fshatin Herbel, Maqellarë, Dibër është miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale Nr. 69, datë 19.02.2020. Sa më sipër, në bazë të Ligjit Nr.35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të” si dhe nenit Nenit 17 pika 1, gërma c) të ligjit Nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ky projekt është objekt i mbrojtjes së të drejtës së		

				autorit dhe si i tillë, i nënshtrohet formaliteteve të ligjeve të sipërcituara dhe nuk mund të përcillet.		
Email	23.05.2022	Kerkese per info, bypassin e Gjirokastrës	23.05.2022	Në Vendimin e Komitetit të Trashëgimisë Botërore 44COM 7B.151, në pikën 6, duke iu referuar projektit të by-pass-it në Gjirokastrë - në zbatim, Komiteti "...kërkon urgjentisht që Shteti Palë të ndalojë ndërtimin e by-pass-it derisa një mision Monitorimi Reaktiv të vizitojë pasurinë për të vlerësuar nëse projekti ka shkaktuar ose do të shkaktojë ndonjë dëm në Outstanding Universal Values". Gjatë periudhës 14-17 dhjetor 2021, u realizua Misioni i Monitorimit Reaktiv në Berat dhe Gjirokastrë nga ICOMOS – ICCROM - QTB Unesco, në të cilën fokusi kryesor ishte projekti i Bypass-it Gjirokastrë. Gjatë takimeve të realizuara me të gjithë palët e interesit, Bashkia Gjirokastrë është shprehur se projekti fillestar i miratuar ka pësuar ndryshime dhe janë devijuar ndërhyrjet në tre urat "pasuri kulturore". Aktualisht, bazuar në rekomandimet e Komitetit të Trashëgimisë Botërore dhe vizitës së Misionit të Monitorimit Reaktiv, Bashkia Gjirokastrë është në proces rishikimi të detajeve të projektit të zbatimit, sipas të cilit objektet pasuri kulturore përgjatë këtij aksi nuk preken. Nuk ka asnjë kërkesë zyrtare të administruar për rishikim statusi të objekteve pasuri kulturore. Në vijim të Misionit të Monitorimit Reaktiv, DRTK Gjirokastrë ka vijuar me kërkesën për pezullim punimesh deri në marrjen e miratimit përkatës të projektit të rishikuar sipas orientimeve të Komitetit të Trashëgimisë Botërore dhe Misionit i Monitorimit Reaktiv.	E plotë	Jo
952	30.05.2022	Kerkese per informacion	08.06.2022	Në vijim të email-it të datës 30.05.2022 nga Ministria e Kulturës ku është përcjellë çështja e Znj. L. F. në Platformën e Bashkëqeverisies, administruar në Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore me datë 30.05.2022, në lidhje me pretendimin për ndërhyrje pa leje në lagjen "Mangakem", Berat, Ju bëjmë me dije se: Bazuar në relacionin e hartuar nga DRTK Berat pas inspektimit në terren dhe verifikimin e dokumentave tekniko-ligjore, rezulton se objekti me emërtim "Rrënojat e familjes Ziu" gëzon status pasuri kulturore, monument kulture kategoria e II-të, shpallur me Vendim të posaçëm të datës 02.06.1961. Për këtë objekt është hartuar projekti me titull "Projekt ringritje e banesës së familjes Ziu n lagjen Mangalem" i cili është	E plotë	Jo

				miratuar në KKTKM me Vendim Nr.72, datë 19.03.2019 Bashkelidhur gjeni kopjen e relacionit hartuar nga DRTK Berat.		
1076/1	16.06.2022	Kerkese per informacion objektin pasuri kulturore “Shtëpia ku lindi Pashko Vasa” në Shkodër	27.06.2022	Në përgjigje të kërkesës Suaj, datë 16.06.2022, administruar në Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore (IKTK) me Nr. 1076 Prot., datë 16.06.2022, lidhur me informacionin për objektin pasuri kulturore “Shtëpia ku lindi Pashko Vasa” në Shkodër, bazuar në ligjin Nr.119/2014 “Për të drejtën e Informimit”, Ju bëjmë me dije se: Objekti “Shtëpia ku lindi Pashko Vasa”, Shkodër është shpallur monument kulture i kategorisë së I-rë me Vendim Nr.1886, datë 10.06.1973, nga Ministria e Arsimit dhe Kulturës. Drejtoritë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore, bazuar në dispozitat e ligjit Nr.27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë” ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e trashëgimisë kulturore, me qëllim gjurmimin, projektimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen, kolaudimin, promovimin, publikimin e trashëgimisë kulturore, në territorin që ato administrojnë. Në zbatim të këtyre dispozitave ligjore, DRTK Shkodër ka kryer inspektime në objektin e sipërcituar dhe në vijim është hartuar projekti i ndërhyrjeve “Restaurim dhe konservim i pjesshëm në çatinë e objektit “Shtëpia ku lindi Pashko Vasa”, i miratuar me Vendim të KKTKM Nr. 311, datë 21.06.2022. IKTK-ja është institucion varësie i Ministrisë së Kulturës, i cili harton studime dhe projekte konservimi e restaurimi në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe nuk administron fonde për financim të ndërhyrjeve në pasuri kulturore. Projekti “Restaurim dhe konservim i pjesshëm në çatinë e objektit “Shtëpia ku lindi Pashko Vasa” parashikon ndërhyrje pjesore për restaurimin e çatisë së objektit dhe ndarjeve të muraturës së çatmasë në interierin e tij. Objekti pasuri kulturore në fjalë është një ndërtesë e shek. 18-19 dhe struktura të kësaj tipologjie paraqesin nevoja për ndërhyrje mirëmbajtëse dhe restauruese të vazhdueshme lidhur me elementët e tyre konstruktivë, arkitektonikë dhe dekorativë.	E plotë	Jo
Email	17.06.2022	Informacion në lidhje me statusin e banesës		Ne proces		

		(pronës) me numër pasurie 18/36, ndodhur në fshatin Nivan të Zagories të bashkisë Libohovë.				
Email	17.06.2022	Kerkese per informacion	22.06.2022	Ne vijim te kerkeses suaj per material per “Kullat e Malesise”, mbështetur në Ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat” dhe ligjin Nr. 119/ 2014 “Për të drejtën e informimit”, ju vendosim ne dispozicion bashkelidhur ne link https://we.tl/t-wy5nqv0fSwm kopje digjitale te disa dokumentave te vjeter arkivor grafik dhe fotografik per objektet si me poshte: Banesa e Shkurte Alise, Breg-Lumë, Shkoder; Kulla e Nikoll Zef Kaçeku, Theth, Shkoder; Banesa e Marash Kola, Abat, Shkoder; Kulla e Lulash Keçit, Theth, Shkoder.	E plotë	Jo
Email	20.06.2022	Kerkese per informacion	20.06.2022	Në vijim të kërkesës suaj për informacion për projektin “Kompleks Vila Banimi 2 kat+ 1 kat nën toke” Braka Residences Diamond Hill, brënda kufirit të Zonës Arkeologjike ‘B’ në Durrës, ju sqarojmë se; Në kuadër të projektit të sipër cituar, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale ka shqyrtuar dhe miratuar Konceptin e Sondazheve Arkeologjike të hartuara nga individi i licencuar në arkeologji Z.Skënder Mucaj, me Vendim Nr. 520 datë 22.12.2020. Pas përfundimit të sondazheve arkeologjike dhe mbikëqyrjes së tyre nga specialistët e Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore janë mbajtur proces verbalet perkatëse në terren sipa akt-marrëveshjes tre palëshe të lidhur mes subjektit zhvillues “Braka Construcion” sh.p.k, Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore dhe Z.Skënder Mucaj. Ju bëjme me dije se pranë Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, nuk është protokolluar nga subjekti i licencuar në arkeologji Z. Skënder Mucaj raporti i rezultateve të sondazheve arkeologjike, i cili duhet të paraqitet për shqyrtim dhe vendim-marrje pranë Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale. Bashkëlidhur gjeni;	E plotë	Jo

				Kopjen e vendimit të miratimit të Konceptit të sondazheve arkeologjike, dhe process verbalet e fillimit dhe të përfundimit të sondazheve arkeologjike.		
Email	21.06.2022	Kerkese per informacion	29.06.2022	Bazuar në kërkesën tuaj për informacion paraqitur pranë Ministrisë së Kulturës, deleguar për trajtim pranë institucionit tonë, datë 21.06.2022, Ju bëjmë me dije për sa më poshtë vijon: “Kontratën e plotë të firmosur midis Delegacionit të Bashkimit Evropian në Tiranë dhe kompanisë ose konsorciumit fitues për grantin me vlerë 619,417 mijë euro me numër kontrate 2015/369281, të akorduar nga Bashkimi European” Lidhur me pikën 1- ju bëjmë me dije se, kontrata të cilës ju i referoheni, është një kontratë dypalëshe e lidhur midis dy subjekteve të ndryshme, në të cilën Institucioni ynë nuk është palë. Si rrjedhim nuk disponojmë asnjë informacion lidhur me këtë pikë. Ky dokument nuk ndodhet në dosjen e supervizimit të periudhës respektive. “Kush është supervizori i punimeve në këtë projekt?” Lidhur me pikën 2 – ju informojmë se, bazuar në dokumentacionin që disponojmë (shkresa Nr.1827 Prot., datë 19.11.2014) Instituti i Monumenteve të Kulturës ka caktuar si supervisor të punimeve për projektin e restaurimit dhe konsolidimit të “Manastirit të Shën Mërisë” në Apolloni specialistët K. Gj. dhe A. D.	E plotë	Jo
Email	22.06.2022	Kerkese per informacion		Ne proces		
1128	24.06.2022	Kerkese per informacion		Ne proces		